



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 182 dt.26.08.1994

PER
MIRATIMIN E SHKEPUTJES SE KANTJERIT TRANSPORTIT
AL – MAK NGA NDERMARRJA E NDERTIMIT AL – MAK,
EMERIMI I DREJTORIT DHE I KESHILLIT DREJTUES

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.26.08.1994, analizoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për shkëputjen nga Ndërmarrja e Ndërtimit “Al – Mak” e Sektorit të Transportit në ndërmarrje më vehte në emrin Kantjeri Transportit “Al – Mak”, vendosjen e drejtorit të kësaj ndërmarrje dhe të këshillit drejtues të ndërmarrjes. Mbështetur në ligjin “Për ndërmarrjet shtetërore” Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.2 dhe të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.10

VENDOSI

1. Krijimin e Kantjerit Transportit Al – Mak.
2. Emërimin e drejtorit të këtij kantjeri Z. Mariana Zhori.
3. Miratimin e këshillit drejtues të përbërë prej :

1.Fatmir Huto
2.Riza Koçi

3.Leonard Pollazi

4.Agim Trasja

4. Paga e drejtorit mbetet në fuqi, paga e ish drejtorit të mëparshëm.
5. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETARI

BESNIK PETRELA